

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË REZERVËS MATERIALE TË SHETIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr.48, datë 19.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.1055/9, datë 19.05.2014, dërguar z.Irfan Dashi, Drejtor i Përgjithshëm i Rezervës Materiale të Shtetit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave sa më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Nga auditimi është konstatuar se nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 14 të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, ku përcaktohet se: “Mënyra e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit rregullohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave”, pasi një udhëzim i tillë edhe pse ka mbi 6 vjet që vepron ligji nuk është hartuar dhe miratuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të merren masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e udhëzimit, kjo në funksion edhe të unifikimit të procedurave të marrjes në dorëzim të mallrave sipas burimit të krijimit të tyre.

Brenda 30.06.2014

2. Nga auditimi i ushtruar rezultoi se, me urdhër të Ministrit të Brendshëm për periudhën 2010-2013, janë kryer transferime kapitale pa pagesë të 77 automjeteve të konfiskuara, nga Drejtoritë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, në institucione brenda dhe jashtë sistemit, referuar pikës 3 të VKM nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore” ku përcaktohet se: *“Mallrat rezervë materiale shtetërore, që nuk financohen nga buxheti i shtetit, në çdo kohë transferohen pa pagesë dhe u shiten, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit, subjekteve, shtetërore ose private, sipas miratimit të organit, që ka këtë kompetencë”*. Gjykojmë se përcaktimi i bërë në këtë pikë të Vendimit të KM lejon hapësira për veprime, transferime pa pagesë apo dhurime edhe për subjektet private, në mënyrë preferenciale sikurse ka rezultuar gjatë këtij auditimi që në dy raste i janë transferuar automjeteve pa pagesë dy shoqatave. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të merren masa për riformulimin dhe propozimin për miratim në KM të pikës 3 të VKM nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore” duke përjashtuar rastet e kalimit pa pagesë të automjeteve në subjektet private, e konkretisht kjo pikë të riformulohet: *“Mallrat rezervë materiale shtetërore, që nuk financohen nga buxheti i shtetit, në çdo kohë transferohen pa pagesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit,*

subjekteve shtetërore, si dhe u shiten subjekteve private, sipas miratimit të organit që ka këtë kompetencë”.

Brenda 30.06.2014

3. Nga auditimi rezultoi se ka raste të transferimit pa pagesë të automjeteve edhe kur nga organet kompetente nuk është marrë vendimi përfundimtar, ndërsa në disa raste automjetet nuk janë gjendje në ambientet e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, e megjithatë janë përfshirë në kryerjen e veprimeve të transferimit, duke realizuar veprime fiktive në kalimin e automjete.

Për të gjitha transferimet pa pagesë të kryera në periudhën 2010-2013, nuk është përcaktuar domosdoshmëria për këto mjete, apo të jetë justifikuar me mungesë të numrit të miratuar me VKM nr.1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”, pasi në këtë periudhë ka shtrirë veprimtarinë e tij ligji nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Për të shmangur e parandaluar në të ardhmen fiktivitetin në rastet e transferimit pa pagesë të automjeteve në subjektet shtetërore, si dhe disiplinimin e përdorimit të këtyre mjeteve, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të merren masa për hartimin dhe miratimin e udhëzimit, ku përcakton procedurat, të cilat duhen ndjekur e zbatuar nga institucionet kërkuuese, posaçërisht për këtë grup mallrash, duke ju referuar në çdo rast kërkesave të VKM nr.1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”.

Brenda 30.06.2014

4. Nga auditimi është konstatuar se, për dhënien e ndihmave apo për shpërndarjen e mallrave rezervë shtetërore nuk ekziston ndonjë udhëzim apo rregullore për procedurat që duhen ndjekur, kërkesë kjo e pikës 4 të VKM nr.1128, datë 5.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin mallrave rezervë materiale shtetërore”, ku përcaktohet se: “Ministri, që mbulon fushën përkatëse, nxjerr udhëzime, ku përcakton procedurat, të cilat duhen ndjekur e zbatuar nga institucionet, që kërkojnë ndihmë me apo për mallra rezervë shtetërore, të grupeve B dhe C, si dhe për rregullimin, në tërësi, të marrëdhënieve, që krijohen në administrimin e mallrave rezervë shtetërore”. Nga konstatimet e auditimit rezultoi se familjet në nevojë (të cilat janë prekur nga fatkeqësitë natyrore) *janë trajtuar me mallra rezervë shtetërore të karakterit kozmetik, pije alkoolike, materiale të tjera konsumi*, etj, të cilat lënë shteg për veprime abuzive. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të merren masat përkatëse për hartimin e miratimin e Udhëzimit përkatës, sipas kërkesave të VKM nr.1128, datë 5.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin mallrave rezervë materiale shtetërore”, që të rregullojë dhe saktësojë procedurat që ndiqen në rastin e këtyre fatkeqësive, si dhe llojet e mallrave që furnizohen në rate të tilla, për të mos i lënë shteg veprimeve abuzive në shpërndarjen e mallrave rezervë shtetërore. Kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë për faktin se në vendin tonë kanë ndodhur pothuaj çdo vit raste të ndryshme të fatkeqësive natyrore.

Brenda 30.06.2014

5. Nga auditimi është konstatuar se në mjaft raste për mallrat ushqimorë, kozmetike dhe medikamente mjekësore, pije freskuese, pije alkoolike etj... të kësaj natyre, të kaluara në

favor të shtetit si pasojë e konfiskimit administrativ kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nuk specifikohen afatet e përdorimit të tyre. Ky fakt sjell vështirësi në bashkëpunimin ndërinstitucional, pasi sipas përcaktimeve të nenit 14/2 të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit nuk merr në dorëzim mallra të skaduar ose në prag të skadimit. Gjithashtu konstatohet se disa prej mallrave të emërtuara si libra, dokumente, materiale të printuara, libra fetarë, broshura, katalogë, dosje me dokumente, katalogë reklame apo me mostra, fletëpalosje, etiketa etj... të kësaj natyre, megjithëse paraqiten me çmime shumë të larta nga institucionet dorëzuese, nuk kanë vlera përdorimi e, si të tilla, nuk i shërbejnë aktivitetit të institucionit, por sipas nenit 4, pika c të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” dhe pikës 2/b, të VKM-së nr.1128, datë 05.08.2008, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit ka detyrimin për t’i marrë në dorëzim si mallra të kaluar në favor të shtetit nga konfiskimet.

Në mjaft raste mallrat e kaluara në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit administrativ e kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dorëzohen në magazinat e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit të përdorura, mungon dokumentacioni i origjinës, prodhuesit, koha e përdorimit etj..., kritere të domosdoshme për përcaktimin e normës së përdorimit-amortizimit dhe për pasojë vështirësitë në përcaktimin e vlerës fillestare të tyre në rastin kur bëhen objekt shetje me ankand publik. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të hartojnë udhëzime të përbashkëta ku të përcaktohen qartë mënyra e kalimit të mallrave të sekuestruara e konfiskuara në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, dokumentacioni shoqërues përkatës, përgjegjësia e secilës palë, si dhe ta propozojnë për miratim nga dy ministritë e linjës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave.

Brenda 30.06.2014

6. Nga auditimi i kryer në zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të objekteve pronë shtetërore, u konstatua se, midis Drejtorisë së Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Financave është nxjerrë Udhëzimi i përbashkët nr 1, datë 16.11.2006 “Për klasifikimin dhe kriteret e përdorimit të të ardhurave që krijohen dhe administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit”. Në zbatim të këtij udhëzimi ish ministri i financave ka miratuar 2 tarifa për depozitim mallra të propozuara në shkresën nr. 507/5, datë 21.12.2006 nga ish Drejtori i Përgjithshëm Ahmet Omi, konkretisht për magazinim të mallrave të lëngëta 5/lekë/toni dhe për magazinim të mallrave të ngurta 4 lekë/toni. **Përcaktimi dhe miratimi i tarifave të mësipërme në mënyrë subjektive dhe pa asnjë argument, është në kundërshtim me tarifat e përcaktuara në vendim të Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 01.07.2009 dhe VKM nr 529, datë 08.06.2011, ka sjellë si pasojë efekt negativ për të ardhurat e buxhetit të shtetit për periudhën 2011-2013 në vlerën prej 46,728,000 lekë.** Për këtë është rekomanduar që:

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit, të marrë masa për të shfuqizuar udhëzimin e përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe Ministrisë së Financave nr. 1, datë 16.11.2006, si dhe anulimin e gjithë kontratave të lidhura nga Drejtoritë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Durrës dhe Vlorë për dhënien me qira të depozitave dhe magazinave pronë shtetërore dhe rilidhjen e tyre konform VKM nr 529, datë 08.06.2011 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive

shtetërore”, kapitulli III, “Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiTEOZë”.

Menjëherë

7. Nga auditimi i kryer në procedurat e zhvillimit të ankandëve të shitjes së mjeteve të konfiskuara konstatohet se, disa prej ankandëve të shitjes së mjeteve për qarkullim kanë dështuar, dhe pas ankandit të tretë mjetet shiten për skrap, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, pasi nga çdo mjet i shitur në formë skrap, krahasuar me shitjen për qarkullim arkëtohen më pak rreth 110,000 lekë. Një ndër shkaqet kryesore që ndryshon destinacionin e mjeteve dhe sjell humbje në të ardhurat buxhetore është tjetërsimi që pëson mjeti, gjatë fazave të lëvizjes së tij, nga gjendje pune në vendin e ndalimit, duke përfunduar me mungesa të mëdha në vendparkimin e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, duke filluar nga nyjet motorike, në sistemin e drejtimit, amortizimit e deri në goma të hequra. Për të minimizuar këtë humbje dhe efektet negative në buxhetin e shtetit, që vjen nga ky ndryshim, **është rekomanduar:**

-Hartimi e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, në mënyrë që automjetet e ndaluara të sekuestruara dhe më pas të konfiskuara të shoqërohen me kartela të veçanta, të inventarizohen sipas gjendjes faktike në çdo fazë të lëvizjes së tyre, të mirëmbahen dhe të konsiderohen pronë publike, pasi shitja në ankand si mjet qarkullimi, sjell të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit.

-Për t'i prerë rrugën ndryshimit të destinacionit për mjetet e konfiskuara, në rast të dështimit të ankandëve të shitjes, të synohet transferimi i tyre për plotësimin e nevojave të subjekteve publike shtetërore.

-Në rastet e ndryshimit të destinacionit të mjeteve dhe shitjes së tyre për skrap, në dokumentat e ankandit duhet të vendoset si kusht, marrja e masave për “*Shtypjen e mjeteve para dorëzimit të tyre tek blerësi*”, me qëllim, përjashtimin e mundësive për ndryshimin e destinacionit në pjesë këmbimi apo në mjete qarkullimi, me pasojë negative për mjedisin, dhe përfitime të pamërituara nga subjekti blerës.

Brenda 30.06.2014

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi është konstatuar se, rezerva shtetërore prej disa vitesh është nën minimumin e saj fizik, për të mos thënë që disa artikuj ushqimore dhe industrialë janë me gjendje zero, ku mallrat e nomenklaturës rezervë shtetërore zënë një sasi mjaft të vogël të totalit të pasqyruar në gjendjen e mallrave. Në këto grup artikujsh janë përfshirë edhe të gjithë mallrat e ndryshme industriale të ardhura nga konfiskimet dhe sekuestrimet, ku rreth 70% të totalit e zë vetëm një artikull (Fletë çadre). **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të marrin masa për të përcaktuar raportin e mallrave ushqimore me mallrat e tjera sipas kërkesave të pikës 2, të VKM nr.1128, datë 5.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin mallrave rezervë materiale shtetërore”, me qëllim që peshën specifike më të madhe ta zënë produktet ushqimore, për të siguruar një minimum të domosdoshëm të mallrave që përdoren në përballimin e situatave emergjente.

Menjëherë

2. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se, Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Vlorë ka dhënë me qira 2 magazina, për të cilat kontrata është lidhur me njësinë matëse m³, me tarifën 4 lekë/toni dhe jo me njësinë matëse m², sikurse është përcaktuar në

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, pika 31, ku është përcaktuar se: Njësia publike duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, dhe në kontratat enfiteozës, germa “c”, është përcaktuar se: “Për objektet e dhëna me qira përcaktohet: Sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik”. Lidhja e kontratave të mësipërme në kundërshtim me këto dispozita për periudhën 2011 - 2012 ka sjellë si pasojë efekte negative për të ardhurat buxhetore në vlerën prej **14,260,000 lekë. Për këtë është rekomanduar që:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit, të marrë masa për anulimin e kontratave të lidhura nga Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Vlorë për subjektet “Nanaj” dhe “Aza” me m³ dhe në vend të saj të hartojë skicat përkatëse për sipërfaqen nën objekt dhe jashtë tij dhe llogaritjet e qirasë vjetore të kryhen sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr 529, datë 08.06.2011 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, kapitulli III, “Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, sipas pozicionit të vendndodhjes me vijat kufizuese të qytetit Vlorë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të përcaktojnë llojin e mallrave që do të trajtohet si rezervë materiale shtetërore, kjo sipas nomenklaturës së miratuar në VKM, që do të mbahet e kontabilizohet në llogarinë 216, si dhe sistemimin e kontabilizimit në llogaritë inventariale të klasës 3 të pasqyrave financiare, për të gjitha mallrave e tjera të trajtuara deri më sot si mallra rezervë.

Menjëherë

3. Nga auditimi është konstatuar se në inventarin e pasurisë së institucionit mallrat e konfiskuara dhe të sekuestruara janë pasqyruar ndër vite me çmim **1 lek**, qoftë automjetet i çdo lloji apo mall ushqimor dhe industrial, me përjashtim të disa rasteve në vitin 2013. Këto mallra kanë marrë vlerë vetëm në momentin e shitjes së tyre në ankand. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa për vlerësimin e këtyre mallrave referuar çmimeve të referencës doganore, çmimeve të publikuara nga INSTAT apo çmimin e tregut, si dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet me vlerën e rezultuar.

Menjëherë

4. Nga auditimi është konstatuar se në mjaft raste të dhënies së mallrave rezervë shtetërore në rastet e fatkeqësive natyrore nuk janë marrë konfirmimet e institucionit pritës (Bashki apo Komunë), në kundërshtim me pikën 56 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë të Financave. Këto marrëdhënie nuk janë pasqyruar në llogarinë 45 “Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”, deri në konfirmimin e tyre, por janë mjaftuar vetëm me paraqitjen e autorizimeve nga subjektet përkatëse, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin kontabël të këtyre marrëdhënieve, si dhe dokumentimin e marrjes së këtyre mallrave nga përfituesit e tyre.

Menjëherë

5. Nga vlerësimi i kryer për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm u konstatua se, Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Mat, ka detyrime të palikuiduara ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OST) në vlerën prej **2,417 mijë lekë**, vlerë e cila kërkohet të arkëtohet nga CEZ shpërndarje. Për këtë detyrim, ndonëse është rekomanduar kryerja e një rakordimi me CEZ-shpërndarje. Deri në fund të vitit 2013 nuk është kryer asnjë rakordim, për të saktësuar origjinën e detyrimit, me qëllim që CEZ të mos përfitojë të ardhura të pamërituara, pasi D R R M Mat, aktualisht nuk figuron debitore ndaj C E Z. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit dhe Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Mat, të marrë masa për të rakorduar me shoqërinë “CEZ Shpërndarje”, për verifikimin e origjinës së detyrimit prej 2,417 mijë lekë, dhe në përfundim, në se detyrimi ka lindur para privatizimit të OST-së, kjo vlerë i takon buxhetit të shtetit, pasi CEZ shpërndarje, ka filluar aktivitetin pa marrë në dorëzim debitorët e OST-së.

Menjëherë

6. Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se debitorët e paarkëtuar ndër vite kapin vlerën rreth 1,600,000 mijë lekë, të cilat përbëhen kryesisht nga produkte ushqimore të shitura ish ndërmarrjeve të grumbullimit (aktualisht të privatizuar), të cilat nuk kanë likuiduar vlerën e fondit kundraparti. Duhet thekuar se, edhe në një rast që Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Mat, nëpërmjet një procesi gjyqësor, ka fituar të drejtën e arkëtimit të detyrimit prej 28,667 mijë lekë nga subjekti privat, por nuk ka mundur të arkëtojë detyrimin pasi nuk ka paguar tarifën përmbartimore 7 %, në vlerën prej 532,470 lekë. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Mat, të marrë menjëherë masa për të bashkëpunuar me Zyrën e Përmbartimit Mat, në mënyrë që, pagesa e tarifës në masën 7 % të vlerës së detyrimit të shërbejë si garanci për arkëtimin e detyrimit, pasi të ardhurat e realizuara nga arkëtimi i detyrimit do jenë 57 herë më të larta se tarifa e paguar.

Menjëherë

7. Nga auditimi për administrimin e mallrave të konfiskuara u konstatua se, në Bankën Tregtare Elbasan mbahen për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit 253,28 gr. Platin, në vlerën prej **524,290 lekë**. Prej datës së konfiskimit dhe deri në fund të vitit 2013, nuk është bërë asnjë verifikim apo krahasim me gjendjen fillestare, duke rrezikuar tjetërsimin e këtij metali të çmuar, pasi ish Banka Tregtare Shtetërore, aktualisht është privatizuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Në zbatim të VKM nr. 405, datë 15.08.1994 “Për një ndryshim në VKM nr. 286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative”, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa për të verifikuar gjendjen faktike të këtij metali të çmuar dhe përgatitjen e dokumentacionit për transferimin e **253,28 gr. Platin në vlerën prej 524,290 lekë** në Bankën e Shtetit Shqiptar.

Menjëherë

8. Nga auditimi u konstatua, se në magazinën e Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Korçë mbahen “mall në ruajtje” 27,000 kg kafe “Arabika”, kjo sasi, ndonëse është shitur në mënyrë të padrejtë nga Zyra e Përmbartimit Korçë me çmim tepër të ulët 88 lekë/kg, por poseduesi i saj, nëpërmjet një procesi gjyqësor kërkon dëmshpërblim nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit, jo vetëm vlerën e kafesë prej 27 milionë lekë por edhe fitimin e munguar prej 6 vjetësh që kalon mbi 10 herë vlerën e arkëtuar nga shitja e saj. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtorja e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa të menjëhershme për bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme, Avokaturën e Shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim përshpejtimin e shqyrtimit të kësaj çështje nga Gjykata e Lartë dhe mbrojtjen e interesave shtetërore.

Menjëherë

9. Nga auditimi i pasqyrave financiare të Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, konstatohet se, janë bërë dalje me të drejtë kthimi, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve produkte ushqimore të kategorisë “rezerva shtetërore” në vlerën prej **798,920 lekë**, respektivisht 6,500 kg oriz, 3,000 kg makarona dhe 4,500 litra vaj ushqimor, të cilat ndonëse kanë kaluar mbi 3 vjet, nuk janë rikthyer në magazinë, duke krijuar në këtë mënyrë vështirësi për t’ju përgjigjur situatave të mundshme emergjente që mund të krijohen. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtorja e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa të menjëhershme për rikthimin e mallrave të emergjencës civile në magazinë në vlerën prej 798,920 lekë, me qëllim garantimin e sasisë ushqimore në përballimin e situatave të emergjencave të mundshme civile.

Menjëherë

10. Nga auditimi i ka rezultuar se, nëpërmjet thyerjes së magazinës “Mborje” të Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Korçë janë “vjedhur 2 motoçikleta”, respektivisht një motor tip “suzuki” me targë Tr 36-63 dhe një motoçikletë, për të cilët nuk është nxjerrë përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, pas denoncimit dhe në përfundim të hetimit kthen përgjigje se, ka vendosur pezullimin e hetimit pasi nuk u gjend autori, për vjedhjen e kryer. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtorja e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të marrë masa të menjëhershme për përcaktimin e vlerës së dy mjeteve dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj rojes së objektit, ■■■■■ i cili sipas vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor ka qenë në punë ditën e thyerjes së magazinës.

Menjëherë

11. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe i të ardhurave të realizuara nga shitja në ankand e mjeteve u konstatua se çmimet e realizuara midis Drejtorive Rajonale kanë ndryshime të theksuara, që ndikojnë negativisht në të ardhurat buxhetore kështu, kështu çmimet më të larta të shitjes së skrapit janë realizuar në Drejtoritë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Vlorë dhe Durrës, respektivisht 40,9 lekë/kg dhe 39,8 lekë/kg, ose 47,6 % dhe 43,6 % më të larta se çmimi mesatar i gjithë Drejtorive Rajonale të marra së bashku. Ndërsa çmimi më i ulët 19,2 lekë/kg, ose 2,4 herë më pak është realizuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë. Ky ndryshim, krahasuar me çmimin mesatar, ka sjellë si pasojë 3,341,100 lekë të ardhura më pak në buxhetin e shtetit. Ky fakt tregon se, ka rezerva të mëdha potenciale në përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit dhe rritjen e të ardhurave

buxhetore, pasi industria metalurgjike ka kërkesë të lartë për “metale në formë skrap. **Për këtë është rekomanduar që:**

Në përcaktimin e çmimit dhe vlerës fillestare të ankandit krahas çmimeve të INSTAT-it, apo çmimeve të njohura nga institucionet e tjera si, organet doganore, tatimore, apo manualët e ndryshme, orientuese duhet të jenë edhe çmimet mesatare të realizuara në fakt, sikurse përcaktohet në pikën 2 germa “b” të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të ankandit”.

Menjëherë

12. Nga auditimi u konstatua se sipas tabelës së hartuar nga Instituti i Studimeve Projektmeve të Metalurgjisë në vitin 2005, skrap i përfituar nga demolimi i mjeteve është cilësuar “jashtë kategorie”, me emërtimin “Skrape të tjera” dhe vlerësimi bëhet me koeficientin 0,46 %. Duke u nisur nga fakti se, mjetet e konfiskuara gjatë viteve të fundit dhe ato që do konfiskohen në vazhdim janë të një teknologjie të përparuar dhe pjesët metalike kanë densitet të lartë, të ngjeshur dhe kanë përmasa më të vogla krahasuar me furrën e uzinës, arrijmë në përfundimin se për këto tregues kërkohet ndryshim në tabelën e vlerësimit relative. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit dhe Drejtoria Teknike, të ngrejë një grup pune, dhe të kërkojnë nga Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Metalurgjisë, për të rishikuar “Tabelën e vlerësimit të kategorive të ndryshme të skrapeve që përfitohen nga mjetet e konfiskuara me qëllim klasifikimin nga “skrap jashtë kategorie” me koeficientin 0,46 në skrap të kategorisë “Gradë 7 A”, me koeficientin 0,56. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi (rivlerësimi), të materialit “të përfituar nga demolimi i mjeteve” të ardhurat buxhetore nga shitja e skrapit në ankand do të rriten me 21 %, mesatarisht në vlerën rreth **2,930 mijë lekë** në vit.

Menjëherë

13. Nga auditimi i dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur praktikës së asgjësimit të duhan cigareve pa pullë fiskale të konfiskuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, u konstatua se, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve, pasi asgjësimi i tyre është shoqëruar pjesërisht me pamje filmike, duke mos pasqyruar gjithë etapat e lëvizjes së tyre nga magazina, llojet e cigareve dhe asgjësimin e tyre me djegie, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit dhe veçanërisht përfaqësuesit e Drejtorive të Përgjithshme të Doganave dhe Tatimeve. **Për këtë është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit t’i propozojë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të hequr nga lista e përfaqësuesve të përhershëm anëtarët e komisionit të asgjësimit të mallrave të akcizës, respektivisht z. ■■■■, përfaqësues i D.P. Tatimeve dhe z. ■■■■ përfaqësues i D.P. Doganave dhe në vend të tyre të përcaktohen persona të tjerë.

Menjëherë

14. Nga auditimi i pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe të Drejtorive Rajonale rezultoi se, në to pasqyrohen detyrime debitore të krijuar ndër vite, që nga viti 1991 e deri në vitin 2013, që arrijnë një vlerë të konsiderueshme prej 1.7 miliard lekë, ku një pjesë e mirë e të cilëve nuk u dihet adresa, nuk ka dokumente pasi janë djegur në trazirat e viteve 1997-1998, si dhe rezultojnë me detyrime debitore të gjitha ish ndërmarrjet e Grumbullimit, të cilat kanë ndërprerë aktivitetin pasi janë privatizuar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të merren masa për të evidentuar debitorët e krijuar para vitit 2000, pa shpresë arkëtimi dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme ti propozohet Këshillit të Ministrave që vlera përkatëse e këtyre debitorëve të shkarkohet nga evidenca kontabile e institucionit, pasi rëndojnë padrejtësisht bilancin, ndërsa për debitorët e krijuar deri më 2013, të evidentohen vlerat përkatëse e dokumentacioni justifikues i tyre, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore e të kërkohej arkëtimi i shumave nga personat fizik, juridik apo shtetëror

Menjëherë

15. Nga auditimi i pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe të Drejtorive Rajonale rezultoi se, për një pjesë e objekteve (depo) të Rezervës Materiale të Shtetit, të cilat aktualisht nuk përdoren, është kërkuar privatizimi i tyre, pasi amortizohen çdo ditë e më shumë dhe vendosja e tyre në zona të largëta e bën të pamundur ruajtjen e tyre, pasi në strukturën e institucionit nuk parashikohen punonjës të shërbimit (roje). **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi, për të mos lejuar degradimin e mëtejshëm të këtyre objekteve dhe humbjen e vlerës së përdorimit.

Menjëherë

16. Nga auditimi i veprimeve të magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe të Drejtorive Rajonale rezultoi se, në inventarin e pasurisë ka mallra e materiale stok dhe me qarkullim të ngadalshëm, të cilat kanë vite që qëndrojnë në magazina dhe kanë humbur vlerën e tyre të përdorimit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit të merren masa për ngritjen e një komisioni të veçantë me specialistë të fushave përkatëse, i cili të evidentojë e të saktësojë sasinë dhe vlerën e tyre, si dhe evadimin e mëtejshëm në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financës “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

17. Krahas veprimtarise efektive të kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, kryesisht në auditimin e pagave, shpenzimeve operative dhe të pasqyrave financiare, të marren masa që të programohen edhe disa auditime tematike së Bashku me Drejtorinë Juridike, për fillimin e procedurave ligjore dhe marrjen e masave ligjore në bashkëpunim me Zyrat e Përmbarimit për arkëtimin e detyrimeve debitore, të cilat sipas bilancit kontabël paraqiten në vlerën prej 1,6 miliardë lekë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, Drejtoria Juridike
Menjëherë

D. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1. Të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore pranë Komisarariatit të Policisë Peqin, mungesën e 4 mjeteve, si diferencë midis listës së mjeteve të paraqitura në ankand dhe

mjeteve të tërhequra në fakt, të konvertuar në 2,429 kg skrap, në vlerën prej **60,045 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

2. Të kërkohej në mënyrë ligjore arkëtimi i vlerës prej **122,850 lekë**, nga kompania e sigurimeve [REDAKTUAR], për mos likuidimin e vlerës 10 % të garancisë së ofertës në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, nga shoqëria [REDAKTUAR] e cila ndonëse është shpallur fituese në ankandin me nr. Ref. 6A/2013, datë 25.06.2013 të zhvilluar në DRRMSH Vlorë për shitjen e 307,125 kg skrap, të përfituar nga 348 automjete të konfiskuara, u konstatua se, nuk është paraqitur për lidhjen e kontratës, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

3. Të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **699,600 lekë** nga ish magazinieri [REDAKTUAR], për mungesën e artikullit “komplete çarçafësh” në sasinë 1,000 copë, si pasojë e veprimeve fiktive të kryera prej tij.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ndaj personave përgjegjës është rekomanduar dhënie e masave disiplinore, por meqenëse disa prej tyre janë larguar nga ky institucion, apo ndaj tyre janë dhënë masa disiplinore, dhënien e tyre e konsideroj të ezauruar. Për masat e marra të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, e konkretisht:

-Për masën disiplinore “largim nga detyra”:

1. z. [REDAKTUAR], Ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë;
2. z. [REDAKTUAR], Ish Drejtor i Përgjithshëm i Rezervës Materiale të Shtetit;
3. z. [REDAKTUAR], Ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë.

- Për masën disiplinore “ulje në detyrë”:

1. znj. [REDAKTUAR], ish Drejtore e Buxhetit dhe Statistikës.

-Për masën disiplinore “Verejtje”:

1. z. [REDAKTUAR], Ish Drejtor i Burimeve Njerëzore;
2. z. [REDAKTUAR], ish specialist në Drejtorinë e Standardeve;
3. znj. [REDAKTUAR] Përgjegjëse e Financës në Drejtorinë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë;
4. znj. [REDAKTUAR] Specialiste e Financës në Drejtorinë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë;
5. z. [REDAKTUAR] Specialist;
6. z. [REDAKTUAR], Specialist;
7. znj. [REDAKTUAR] Specialiste.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT